## DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR

## PROCEDURËN E KUFIZUAR

## SHËRBIME, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR[1]

# “SHËRBIM I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E QENDRËS SPITALORE RAJONALE “SHEFQET NDROQI”

Qershor 2026

[1] **Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, Autoriteti/Enti kontraktor do t’i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.**

**2 Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.**

## NJOFTIME

### NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)*

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**;

Emri _____________________________________________

Adresa _____________________________________________

1.2 **Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| Institucion qendror | Institucioni i pavarur |
|---|---|
| ☐ | ☐ |
| Njësi e autoriteteve vendore | Të tjera |
| ☐ | ☐ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta | Organ Qendror blerës | Ofrues shërbimi Publik | Ofrues shërbimi Privat |
|---|---|---|---|
| ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| I deleguar | | Të tjera | |
| ☐ | | ☐ | |

**1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit**:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: _____________________________________________
Tel/faks ____________________________________________________________________
E-mail ____________________________________________________________________

**1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**
______________________________________________________________________________

**1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:** ____________________________

**1.7 Tipi i kontratës**:_____________________________________________

**1.8 Fondi limit i përllogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përllogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor**
(*në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjecare*) :
_____________________________________________________________________

**1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër :**_________________________________
**1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**
_______________________________________________________________________________________
_______________________________________________________________________________________

**1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:**
______________________________________________________________________

**1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:**
_________________________________________________________________

**1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor:**________________________________________________________________
________________________________________________________________

**Shënim:**

**Nëse ky njoftim paraprak i informacionit përdoret si një ftesë për ofertë, është i nevojshëm informacioni i mëposhtëm:**

**1.12 Përshkrimi specifik i shërbimeve që do të jenë objekt i kontratës**
______________________________________________________________
_______________________________________________________________________________________
_______________________________________________________________________________________

**1.13 Të përcaktohet nëse kontrata do të jepet përmes procedurës së kufizuar, pa shpallje të mëtejshme të një thirrje për oferta dhe operatorët e interesuar ekonomikë janë të ftuar të shprehin interesin e tyre.**

____________________________________________________

# NJOFTIMI I KONTRATËS

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor )*

## <u>Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor</u>

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri: | Operatori i Blerjeve të Përqendruara |
| Adresa: | Rr. "Reshit Çollaku", godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë |
| Tel/Faks: | |
| E-mail: | info@obp.al |
| Adresa e ueb-faqes: | www.obp.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | D.B<br>sektori_sherbimet@obp.al |

**1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Institucion qendror ☐

Institucioni i pavarur ☐

Njësi e autoriteteve vendore ☐

Të tjera **X**

**1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐

Organ Qendror blerës X

Ofrues shërbimi: Publik ☐ Privat ☐

I deleguar ☐

Të tjera ☐

**1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.6 Kontratë e rezervuar :**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**Seksioni 2: Objekti i Kontratës: "Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi"**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-89368-06-09-2026**

**2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 98310000-9**

**2.3 Lloji i "Kontratës Publike për Shërbime"**

**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:**

Po **X** Jo ☐

**2. 5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:**

**Me një Operator Ekonomik** **X**

**Me disa Operatorë Ekonomikë** ☐

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po **X** Jo ☐

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

Kjo procedurë është përzgjedhur, pasi shërbimi objekt pokurimi është një shërbim i përditshëm 24/7 në ambientin e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi". Duke qenë se shërbimet, objekt prokurimi, përdoren në natyrë të përsëritur dhe sasitë janë të pritshme, forma juridike e finalizimit të proçesit të prokurimit do të jetë me "Marrëveshje Kuadër", me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, parashikuar në nenin 52 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", në nenin 63, në pikën 1 nënpika a) të Nenit 64 të VKM së nr. 285 datë 19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik".
Të gjitha kushtet e kontratës do të jenë të përcaktuara ashtu si dhe cmimet e ofertës fituese dhe sherbimi do të kryhet bazuar në këto kushte e cmime.
Kjo procedurë e përzgjedhur garanton dhe siguron efiktivitet në lidhje të realizimit me shpejtësi të shërbimit, pasi ato do të kryhen në mënyrë periodike dhe në varësi të nevojave të AK.
Marrëveshja Kuadër më shumë operatore do të sillte vonesa, të cilat në rastin konkret do ta bënin jo efektive aplikimin e kësaj procedure, si dhe do të krijonte vështirësi, si nga ana organizative ashtu edhe nga ana funksionale. Marrëveshja Kuadër më shumë operatorë mund të krijojë standarte të ndryshme higjeno-sanitare, mund të cënojë cilësinë dhe higjenën e materialeve të buta, fragmentarizon përgjegjësinë, duke sjellë kështu vështirësi në monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës/ave që do të lidhen.
Shërbimi i lavanderisë për spitalin është një shërbim që lidhet ngushtë me kontrollin e infeksioneve dhe sigurinë e pacientëve, ku standartet higjeno sanitare duhet të jenë të unifikuara, standarte të cilat arrihen përmes një operatori të vetëm. Marrëveshja Kuadër me një operator garanton realizimin e shërbimit në

| |
|---|
| kohë, në afat dhe në llojin e cilësinë e kërkuar të objektit të prokurimit, pasi kemi përsëritje të shpeshta të kryerjes së shërbimeve për nevojat e Institucionit. |

**2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:**

**Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ___** (*Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)*

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

| | | |
|---|---|---|
| | | Nuk do të ketë rihapje të konkursit.<br>Kontrata/ kontratat do të lidhen sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm.<br>Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT.<br>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër.<br>Ne rast te lindjes se nevojes konkrete per te lidhur nje kontrate brenda marrëveshjes kuader, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë "ftesën për ofertë" tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasitë përkatëse të artikujve.<br>Autoriteti kontraktor i kerkon operatorit ekonomik fitues, te japë oferten e tij.<br>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures.<br>Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. |

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:**

**Organi Qendror Blerës "Operatori i Blerjeve te Perqendruara" në emër dhe për llogari të autoritetit kontraktor:**

**Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi"**

**2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 251,259,120.12 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet pikë dymbëdhjetë) lekë pa tvsh, ose 2,639,831.06 (dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e një pike zero gjashtë) Euro pa tvsh.

*(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (95.18), datë 09.06.2026)*

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa shërbime, **shumatorja e çmimeve për njësi është** _________

3. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

4. Kodi Output: 1234567

5. Tipi:

Investime □ Kodi: ______ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 602 Vlera: 251,259,120.12 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet pikë dymbëdhjetë) lekë pa tvsh

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**

Kohëzgjatja **në muaj** □□□ **ose ditë** □□□

Ose
Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

**Kohëzgjatja në muaj: 48 (dyzet e tetë) Muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër**

*Ose* **fillon më** ____/____/________ **(d/m/v)**

**mbaron më** ____/____/________ **(d/m/v)**

**2.12 Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

**Në ambientet e AK për llogari të së cilit OBP po zhvillon procedurën e prokurimit:**

Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës

**2.13 Ndarja në Lote:**

**Po** □ **Jo** **X**

*Autoriteti Kontraktor përfitues ka vendosur që procedura e prokurimit me objekt: "Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" të mos kryhet e ndarë në lote, pasi shërbimi i lavanderisë për Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", përbën një shërbim të vetëm, të integruar dhe funksionalisht të pandashëm. Ndarja ne lote do te krijonte fragmentim të shërbimit, standarde të ndryshme operative, vështirësi në kontrollin e cilësisë, mbivendosje përgjegjësish dhe rrezik për mospërmbushje të njëtrajtshme të nevojave spitalore. Mosndarja në lote garanton menaxhim unik të kontratës, përgjegjësi të qartë të operatorit ekonomik, uniformitet të standardeve higjieno-sanitare, eficiencë logjistike dhe ekonomi shkalle. Ndarja në lote nuk sjell avantazh ekonomik apo funksional të provueshëm për autoritetin kontraktor dhe nuk është e përshtatshme për natyrën e këtij shërbimi.*

*Nëse po,*

**2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:**

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1.___________________________

2.___________________________

**2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:**

□ një Lot,

□ disa Lote,

□ të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:**

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi __________

**2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**

**Po** □ **Jo** □

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

______________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

**2.15 Pranohen variantet:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | ☐ | **Jo** | **X** |

**2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | ☐ | **Jo** | **X** |

**Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:**
*(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)*
______________________________________________________________________________

**2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | ☐ | **Jo** | **X** |

**Shënime të tjera** *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

______________________________________________________________________________

_________________________________________________________________________

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | **X** | **Jo** | ☐ |

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:**

Ndalohet mbështetja për seksionin e kushteve të vecanta për kualifikim 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" dhe "2.3 Kapaciteti teknik" pasi kapacitetet ekonomiko-financiare dhe teknike janë të domosdoshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe janë të lidhura ngushtësisht me ofertuesin, pasi tregojnë kapacitete reale të tij. Shërbimi objekt prokurimi ka natyrë shërbimi periodik, në ambientet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", dhe rëndësi jetike për funksioninim e këtij spitali.

Karakteri specifik dhe i vazhdueshëm operacional, me një kohëzgjatje relativisht të gjatë prej 48 muajsh, kërkon kapacitete reale ekonomike, teknike, përvojë, infrastrukturë të dedikuar, logjistikë të posaçme, siguri teknike të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e standarteve të cilësisë së kujdesit shëndetësor, ruajtjen e higjenës dhe mbrojtjen e shëndetit publik brenda ambienteve spitalore.

Këto kritere vlerësohen si karakteristika të vetë subjektit ofertues, të cilat tregojnë nëse ai është i aftë të përballojë detyrimet kontraktore, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura nga AK. Si rrjedhojë, ndalimi i mbështetjes në këto kritere garanton përgjegjësi të drejtëpërdrejtë, besueshmëri në ekzekutimin e kontratës/ave, si dhe vazhdueshmëri të shërbimit.
Gjithashtu, duke qene nje marreveshje kuader me afat 48 muaj, mbeshtetja ne kapacitetet e operatoreve ekonomike te tjere per elemente te realizimit ne nje periudhe kaq te gjate, do te krijonte pasiguri juridike.

**<u>2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:</u>**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**<u>2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:</u>**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**<u>Seksioni 3:Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike</u>**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (*e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **5,025,182.40 (pesë milion e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pikë dyzet) lekë ose 52,796.62 (pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e dy) Euro.**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 ____________________ (*shuma,monedha)*
*Loti 2* ____________________ *(shuma monedha)*

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor:

**Credins Bank**
**SWIFT:CDISALTRXXX**
**NR.LLOGARIE: 00002032030**

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**
ose
ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 DITË** *(shprehur në ditë)*

**<u>Seksioni 4: Procedura</u>**

**4.1 Lloji i procedurës: E Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar**

**4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:**

| **Po** | □ | **Jo** | **X** |
|---|---|---|---|

Nëse Po, numri i referencës është _____________________

**4.2.1.Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

| **Po** | **X** Afati shkurtohet me 5 ditë, pasi procedura zhvillohet me mjete elektronike | **Jo** | |
|---|---|---|---|

**4.3 Procedurë e rishpallur:**

| **Po** | □ | **Jo** | **X** |
|---|---|---|---|

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit_____________________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit ___________________________

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____________________________(*shuma* , *monedha*)

**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A)[2] **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

çmimi □ pikët □□

_______□□ pikët □□

_______ □ □ pikët □□

_______ □□ pikët □□

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

---

[2] **Shënim.** *Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.*

**OSE**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

**Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi** (*Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të vlerësuar).*

**4.4 Ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen**

**4.4.1 Do të aplikohet ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

Nëse Po:

Numri minimal i kandidatëve që do të ftohen është: __________________

Numri maksimal i kandidatëve që do të ftohen është (sipas rastit): __________________

**4.4.2 Kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për uljen e numrit të kandidatëve:**

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

**4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:**

Data: **06/07/2026** *(d/m/v)* **ora 11:00**

Vendi: **www.app.gov.al.**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.**

**4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 43 pika 7 të LPP** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

**Po** ☐ **Jo X**

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

**4.6 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Shqip** | **X** | **Anglisht** | **X** |

**Seksioni 5: Informacione shtesë:**

**5.1 Dokumente me pagesë** *(zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | ☐ | **Jo** | **X** |

*Nëse po*

**Monedha** _________ **Çmimi** _______

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (**kur është e aplikueshme)

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softë erike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 09/06/2026

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti /Enti Kontraktor*]

**FTESË PËR SHPREHJE INTERESI**

**Procedura e Prokurimit**: ______________________________

(*shënoni emrin e Autoritetit /Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

……………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve të kërkuara)

**Kërkesat për pjesëmarrje duhet të paraqiten në:**
*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje:**

[Përcaktoni datën dhe orën]

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit*]

**FTESË PËR OFERTË**

(*Shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

…………………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve dhe sasisë konkrete të kërkuar:

**Vendi i kryerjes së shërbimit**: (jepni një përshkrim të shkurtër*)*___________________

**Koha e realizimit të shërbimit/eve**: Shërbimi duhet të realizohet ____________

**Ofertat duhet të paraqiten në:**
…………………………………………………………………………………*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për pranimin e ofertave:**

……………………………………………………………………………………………………

[Përcaktoni datën dhe orën]

**Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese** ________________________________________

Forma e komunikimit:

Forma shkresore□ Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) □

## NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Adresa Rruga "Reshit Çollaku", godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)
Tel/Faks ___________________________________
E-mail info@obp.al;
Ueb-faqe www.obp.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-89368-06-09-2026**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi"**

**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 98310000-9**

**6. Fondi limit**: 251,259,120.12 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet pikë dymbëdhjetë) lekë pa tvsh, ose 2,639,831.06 (dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e një pike zero gjashtë) Euro pa tvsh.

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 48 (dyzet e tetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër**

**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data 06/07/2026 Ora 11:00**

**9. Procedurë e Rishpallur:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | ☐ | **Jo** | **X** |

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit_______________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit ___________________________

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____________________________(*shuma* , *monedha*)

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**

**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Shërbime:

Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

_____

| **Numri i kontratës** | **Titulli i kontratës** | **Përshkrimi i shkurtër i kontratës** |
|---|---|---|
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

Shënim: *Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.*

(*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* )

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Faks______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Ueb-faqe______________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: _________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: ___________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:_________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_________**

**8. Fondi limit :_____________________________________________**

**9. Justifikimi, argumentet përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumenteve të tenderit:**

______________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________________

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:___________**

**<u>Shënim:</u>**

**Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentet e tenderit.**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe____________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit:** ______________________________

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër:**______________________________

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:**_________________________

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :**_______________________

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**_______________

**8. Fondi limit:** ____________________________________________

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

_______________________________________

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________

**11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:** ________________________________

**12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):**_______________________________________

**13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** ________________________

**Dhe afati i ri (nëse është rasti):** _____________________________

**14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:**

Emri_____________________________

NIPT: ________________________

Adresa ___________________________

Kontaktet __________________________

**15. Data e nënshkrimit të modifikimit :**______________________

**16. Burimi i financimit:** ________________________________

**17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor**_______________________________________________________________________________

_________________________________________________________________________________

# DOKUMENTET E TENDERIT

**Përmbajtja:**

**Seksioni I:** **<u>Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)</u>**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit te Kontratës.

**Seksioni II:** **<u>Shtojcat</u>**

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e Kerkeses per pjesemarrje dhe /ose ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

**Seksioni III.** **<u>Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)</u>**

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

**Seksioni IV:** **Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

# Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

## A. TË PËRGJITHSHME

**1. Objekti i prokurimit**

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.

2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

Kjo procedurë përbëhet nga dy faza kryesore:

**Faza 1 - Parakualifikimi:** Kandidatët do të paraqesin dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti/Enti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentet e paraqitura nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Faza 2 - Ftesa për oferta**: Autoriteti/Enti Kontraktor i dërgon ftesë për ofertë Kandidatëve të cilët kanë përmbushur kërkesat e parakualifikimit, me anë të së cilës i fton këta Kandidatë të paraqesin një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të rishikohen dhe vlerësohen nga Autoriteti / Enti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

**2. Operatorët Ekonomikë**

a)"Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1 Të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare.

1.2 BOE i bashkëlidh Kerkeses per pjesëmarrje dhe Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Kerkeses per Pjesemarrje dhe /ose Ofertës.

**3. Sqarimi i Njoftimit të Kontratës dhe Dokumenteve të Tenderit**

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të kerkeses per pjesemarrje dhe/ose ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit**

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje/ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.

2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i Dokumenteve tëTenderit.

3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e tyre. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e tyre me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

## B. PËRGATITJA E KËRKESËS PËR PJESËMARRJE DHE OFERTAVE

**5. Shpenzimet e ofertimit**

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

**6. Gjuha e Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

**7. Dokumentet përbërëse të Kërkesës për pjesëmarrje/ Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje / Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

| | |
|---|---|
| **8. Formularët e ofertës** | 1 Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.<br><br>2 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës për pjesëmarrje/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës për pjesëmarrje /ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesën për pjesëmarrje /ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar. |
| **9. Ofertat Alternative** | Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh. |
| **10. Çmimet** | 1 Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.<br><br>2 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre.<br><br>3 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë, në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe, duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.<br><br>4 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimet pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.<br><br>5 Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër. |
| **11. Monedhat** | Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës. |
| **12. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik** | Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat. |

| | |
|---|---|
| **13. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës** | 1 Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.<br>2 Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:<br>a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor<br>b) Garanci bankare<br>c) Garanci sigurimi<br>Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.<br>3 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.<br>4 Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë Operatori Ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet. |
| **14. Formati dhe Nënshkrimi i Kërkesës per Pjesëmarrje dhe Ofertave** | Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet kërkesën për pjesëmarrje sipas formularëve standard në këtë DT, e cila do të nënshkruhet nga personi/at i autorizuar për këtë qëllim. Kur të ftohet nga autoriteti/ enti kontraktor për të paraqitur një ofertë sipas formularëve standard në këtë DT, Oferta do të nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim. |
| **15. Konfidencialiteti** | Autoriteti /enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së |

## C. PARAQITJA, HAPJA DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE /OFERTAVE

| | |
|---|---|
| **16. Kërkesa për Pjesëmarrje/Oferta.** | 1 Operatori ekonomik paraqet kërkesë për pjesëmarrje/ofertën duke përdorur formularet e paraqitur në Seksionin II dhe III. Formularët duhet të plotësohet pa asnjë ndryshim të formatit të tij, dhe nuk do të pranohen |

zëvendësime. Të gjitha hapësirat boshe do të plotësohen me informacionin e kërkuar.

**17. Dokumente që provojnë kualifikimet e operatorit ekonomik**

1. Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

**2** Mosparaqitja e informacionit, i cili është thelbësor për të vlerësuar kualifikimet e operatorit ekonomik, do të rezultojë në skualifikimin e operatorit ekonomik.

**18 Paraqitja, e kërkesës për pjesëmarrje/Ofertës**

**1.** Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatori ekonomik ngarkon kërkesën për pjesëmarrje/ofertën në Sistemin e Prokurimit Elektronik sipas përcaktimeve në manualet përkatëse.

**2.** Sa i takon procedurave të prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, operatori ekonomik paraqet vetëm kërkesën origjinale për pjesëmarrje/Ofertës të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e operatorit ekonomik dhe të shënuar: "**Kërkesë për pjesëmarrje/Ofertë; Njoftimi Nr. __.**

**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA -------------- d/m/v, në orën------------"**

**19.Afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje /Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta duhet të paraqitet dhe hapet nga autoriteti/ enti kontraktor jo më vonë se data dhe ora e përcaktuar në njoftimin e kontratës/Ftesë për Ofertë.

**20.Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë kërkesën për pjesëmarrje/Ofertën , në çdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të saj.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin kërkesëspër pjesemarrje/Ofertën me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit /entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e tyre. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM Kërkesë për pjesëmarrje/Oferte" ose "TËRHEQJE Kërkesë për pjesërmarrje/Oferte

**21. Kualifikimi i operatorëve ekonomikë**

1 Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se

Kërkesa e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Kërkesës për pjesëmarrje/Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) .

## D. NJOFTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

**22.Njoftimi i kualifikimit apo përzgjedhjes**

1 Autoriteti/enti kontraktor njofton operatorët ekonomikë për rezultatet e fazës së parë të procedurës. Ky njoftim përfshin, minimalisht: emrat e operatorëve ekonomikë të kualifikuar apo operatorëve ekonomikë të përzgjedhur për tu ftuar për të paraqitur oferta.

2.Njoftimi që duhet t'i dërgohet operatorëve ekonomikë do të deklarojë arsyet specifike për refuzimin e kërkesës së tyre për pjesëmarrje.

3.Autoriteti/ enti kontraktor do të ftojë të paraqesin ofertë për kontratën vetëm ata operatorë ekonomikë që janë kualifikuar në fazën e parë.

## DH. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

**23.Paraqitja e Ofertave**

Ofertat do të paraqiten vetëm nga operatorët ekonomikë që kanë marrë një ftesë për ofertë nga autoriteti/ enti kontraktor.

**24. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur

**Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formularin e Ofertës Ekonomike.

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione* etj)
___________ ,
___________ ,

c) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

**E. VLERËSIMI I OFERTAVE**

**25. Përgjegjshmëria e ofertave**

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

(a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
(b) “**Rezervim**” është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
(c) “**Mospranim”** është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet

**F. VLERËSIMI I OFERTAVE**

**26 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kritereve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**<u>Opsioni 1) Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:</u>**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

**a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 ____Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**b)Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Ok1 x Pmaxk1 /Vmax k1

Vmaxk1_____Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 ______ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme autoritetet/entet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

**Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë**

**Kriteret e Vlerësimit** **Pikët**

**(i) Përvoja per Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik**

**Nënkriteret**[3]

**i/a Përvoja për punë të ngjashme**

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

**i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë**

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

**(ii) Metodologjia e Propozuar**

**Nënkriteret**

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

[3] *Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.*

ii.c. Organizimi i Stafit

**ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:** Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

**ii/c. Organizimi dhe Stafi:** Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. **Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik
Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

**Pe = 100 x Çu / Ç**
(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

**<u>Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:</u>**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës së kualifikuar.

**SHENIM: 1.** Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

**26. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

**(a)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

**2**. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

**2.1** Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + … On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ......... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes se shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## D. DHËNIA E KONTRATËS

**27. Njoftimi i Fituesit** Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

b) garanci bankare

c) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

**29. Procedura e ankesës**

1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t´u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2.Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik

3 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

**30 Anulimi i procedurës**

1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021 të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikës 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njejtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në sistemin e prokurimit elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për Pjesëmarrje

Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për Kandidatët e përzgjedhur, faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4. Lista e Çmimeve sipas Elementëve Përbërës të Shërbimit

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojcë 7. Deklaratë mbi disponueshmërinë e Anëtarit të Stafit

Shtojca 8. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 9. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 10. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 11. Formulari i Kritereve Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 12. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit

Shtojca 13.Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 17. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 18: Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

**Shtojca 1**

*(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)*

**FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE**

Emri i **Operatorit Ekonomik____________________**

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i referencës së procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/ përzgjedhur bazuar në kerkesën për pjesëmarrje)*

**FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË**

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

_____________________________________________

Procedura e prokurimit________________/

Numri i procedurës / referenca e Lotit ______________

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë, Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:**

Data (d/m/v) Ora: ____________________________

Adresa ____________________________________________________________________________

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, **www.app.gov.al.**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:**

Shqip  Anglisht 

Tjetër ________________________

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) [4]**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto** 

Sipas rëndësisë:

Çmimi  pikët

_______ pikët 

_______  pikët 

______  pikët 

<u>Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.</u>

<u>**OSE**</u>

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim** 

<u>**Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (**</u>*Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasitë janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).*

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

**[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]**

[4] *Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.*

**Shtojca 3**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**[5]

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elemetëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

[5] *Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.*

7. Lista e Çmimeve sipas elemetëve përbërës të shërbimit.

**e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: **------------- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data**: ______________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** ____________________________________

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): ___________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementët përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| ***1*** | ***2*** | ***3*** | ***4*** | ***5*** | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Përshkrimi i elementëve përbërës të Ofertës Ekonomike** | **Sasia** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total (*3* x *4X*)** | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | **Çmimi total** | | | | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |

| | |
|---|---|
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 6**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 7**

(*[6]Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARAT[7]Ë**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Unë i nënshkruari ____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "..............................................." për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "……………………………………..'' të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt …………………………………………………………, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

[7] *Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme*

**Shtojca 8.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**"SHËRBIM I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E QENDRËS SPITALORE RAJONALE "SHEFQET NDROQI"**

**Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet duhet të ofrojë një shërbim të integruar, i cili përfshin:**

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë dhe Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Kavajë, sipas grafikëve të përcaktuar, në përputhje me rregulloret, protokollet e higjienës dhe manualet e kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit të butë në përputhje me standardet përkatëse higjieno-sanitare;
- Hekurosjen dhe paketimin e materialit të butë;
- Shpërndarjen e materialit të larë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Kavajë, sipas grafikëve të miratuar;
- Shtrimin e shtratit të pacientit.

**Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, nga dita e hënë deri ditën e diel.** Operatori ekonomik privat duhet të sigurojë inventarin e nevojshëm të materialit të butë për mbulimin e nevojave të pavioneve, përfshirë fundjavën, si dhe për shtrimin e shtretërve të pacientëve.

Gjithashtu, operatori duhet të garantojë:

- Lënien në dispozicion të një baze materiale rezervë për nevoja të shërbimit gjatë shtrimeve të reja gjatë natës, rasteve urgjente, si dhe situatave të tjera të paparashikuara;
- Zbatimin e grafikut të përcaktuar për ndërrimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse;
- Përmbushjen e kërkesave të Kryeinfermierëve të pavioneve në rastet kur ndërrimi i materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

**Në kontratën e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë duhet të parashikohen, ndër të tjera, këto elemente kryesore:**

I. Larja e materialeve të buta, në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe rregulloret për parandalimin e infeksioneve spitalore;
II. Specifikimet teknike të materialit të butë (cilësia, përbërja, qëndrueshmëria, standardet e sigurisë, etj.);

III. Etapat e menaxhimit të procesit të lavanderisë, nga grumbullimi i materialit të papastër deri në dorëzimin e materialit të larë dhe të paketuar në pavione.

Referuar të dhënave elektronike të dërguara nga shërbimi i statistikës me date 16.10.2025 protokolluar me nr.91/20 prot. datë 16.10.2025, shërbimi ne Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Njesia Tiranë ofrohet ne numrin prej 213 shtretër dhe ne numrin prej 86 shtretër ne Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Njesia Kavajë.
Ky vlerësim është marrë në konsideratë për të mundësuar një përllogaritje të saktë dhe realiste të volumit të shërbimit që do të ofrohet në këto qendra spitalore.
Numri prej 243 shtretërsh përbën bazën mbi të cilën llogaritet aktiviteti spitalor, si dhe kapaciteti i hospitalizimit dhe ofrimit të shërbimit për pacientët.
Duke qenë se ky numër përfshin edhe shtretërit e shtuar gjatë periudhës së epidemisë së COVID-19 në spitalet COVID, grupi i punës parashikon që numri i përgjithshëm i shtretërve do të mbetet i pandryshuar edhe gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Gjithashtu në parashikim do të futen edhe 7 shtreterit e mjekeve te sherbimit roje 24 ore mbi 24 ore ne Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njesia Tirane dhe 3 shtreterit e mjekeve te sherbimit roje 24 ore mbi 24 ore ne Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njesia Kavaje, dhe mjekë roje i shtohet edhe mjeke te tjere specializante dhe që kanë shtratin e tyre për të cilët nevojitet vënia ne dispozicion e sherbimit te lavanderise.

Duke iu referuar strukturës së miratuar nga Ministria e Shendetesise dhe Mireqenies Sociale numri i shtreterve per mjeket e sherbimit roje ne Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tirane dhe ne Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje; do te ofroje sherbim ne total 13 shtreter.

Në këto kushte, analiza është kryer duke marrë parasysh numrin real të shtretërve.

Në rast të nevojave shtesë, për shkak të emergjencave, epidemiave në vend ose forcave madhore, numri i shtretërve mund të rritet. Për këtë arsye, duhet të sigurohet sasia e duhur e inventarit të materialit të butë, për t'u mbuluar këto raste.

**Tabela Njesia Tirane**

| **Nr.** | **Emërtimi i Shërbimit / Klinikës** | **Numri i shtretërve** |
|---|---|---|
| 1 | Klinika I e Pneumologjisë | 60 |
| 2 | Klinika II e Pneumologjisë | 60 |
| 3 | Klinika e Mjekësisë Interne | 15 |
| 4 | Shërbimi i Kardiologjisë dhe Hemodinamikës | 20 |

| | | |
|---|---|---|
| 5 | Klinika e Kardio-Kirurgjisë | 15 |
| 6 | Klinika e Kirurgjisë Torakale | 20 |
| 7 | Klinika e Kirurgjisë Abdominale dhe Ortopedisë | 15 |
| 8 | Shërbimi Spitalor i Anestezi-Reanimacionit | 8 |
| 9 | Urgjenca | 23 |
| 10 | Mjek Roje | 7 |
| | **Totali** | **243** |

**Nga sa më sipër, numri total i shtretërve që duhet të pajisen me bazë materiale dhe të mbulohen nga shërbimi i lavanderisë është 243 shtretër për Njësinë Tiranë.**

**Tabela Njesia Kavaje**

| ***Nr.*** | ***Emertimi*** | ***Numri i shtreterve*** |
|---|---|---|
| ***1*** | *Sherbimi i Mjekesise se Pergjithshme* | 20 |
| ***2*** | *Sherbimi i Kirurgjise se Pergjithshme, Ortopedi-Traumatologjise, urologjise* | 26 |
| ***3*** | *Sherbimi i Pediatrise* | 20 |
| ***4*** | *Sherbimi i Obstetrike-Gjinekologjise* | 20 |
| ***9*** | Urgjenca | 4 |
| ***10*** | Mjek Roje | 3 |
| ***Totali*** | | **93** |

**Nga sa më sipër, numri total i shtretërve që duhet të pajisen me bazë materiale dhe të mbulohen nga shërbimi i lavanderisë është 93 shtretër për Njësinë Kavajë.**

Po ashtu, në tabelat në vijim paraqitet koeficienti i shfrytëzimit të shtratit, i detajuar për per Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njësia Tiranëe dhe Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njësia Kavajë.

**Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njësia Tiranë**

| **Nr.** | ***Emertimi*** | ***Viti 2023*** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ***Gjithsej te hyre*** | ***Dite-paciente*** | ***Dite-qendrimi mesatar*** | ***Shfrytezim shtrati*** | ***Xhiro-shtrati*** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sherbimi I (Pneumologji) | 1793 | 20532 | 11.98 | 93.75 | 28.57 |
| 2 | Sherbimi II (Pneumologji) | 1785 | 18457 | 10.73 | 84.28 | 28.67 |
| 3 | Mjekesia Interne | 310 | 4032 | 13.09 | 73.64 | 20.53 |
| 4 | Kardiologjia + Hemodinamikas | 1716 | 5278 | 3.17 | 72.30 | 83.15 |
| 5 | Kardiokirurgjia | 308 | 4025 | 10.59 | 73.52 | 25.33 |
| 6 | Kirurgji e Pergjithshme | 904 | 6337 | 7.05 | 115.74 | 59.93 |
| 7 | Kirurgjia Torakale | 539 | 5666 | 8.66 | 77.62 | 32.70 |
| 8 | Reanimacioni | 198 | 2995 | 14.40 | 102.57 | 26.00 |
| **Totali** | | **7553** | **67322** | **8.92** | **86.59** | **35.43** |

| **Nr.** | ***Emertimi*** | ***Viti 2024*** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ***Gjithsej te hyre*** | ***Dite-paciente*** | ***Dite-qendrimi mesatar*** | ***Shfrytezim shtrati*** | ***Xhiro-shtrati*** |
| 1 | Sherbimi I (Pneumologji) | 1805 | 20123 | 11.45 | 91.89 | 29.30 |
| 2 | Sherbimi II (Pneumologji) | 1890 | 19034 | 10.59 | 86.91 | 29.97 |
| 3 | Mjekesia Interne | 388 | 4819 | 11.75 | 88.02 | 27.33 |
| 4 | Kardiologjia + Hemodinamikas | 2622 | 7179 | 2.89 | 98.34 | 124.00 |
| 5 | Kardiokirurgjia | 336 | 5176 | 10.78 | 94.54 | 32.00 |
| 6 | Kirurgji e Pergjithshme | 927 | 5746 | 6.42 | 104.95 | 59.67 |
| 7 | Kirurgjia Torakale | 572 | 6121 | 8.63 | 83.85 | 33.45 |
| 8 | Reanimacioni | 257 | 3162 | 11.09 | 108.29 | 35.63 |
| **Totali** | | **8797** | **71360** | **8.09** | **91.78** | **41.38** |

| **Nr.** | ***Emertimi*** | ***Viti 2025*** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ***Gjithsej te hyre*** | ***Dite-paciente*** | ***Dite-qendrimi mesatar*** | ***Shfrytezim shtrati*** | ***Xhiro-shtrati*** |
| 1 | Sherbimi I (Pneumologji) | 1908 | 21179 | 11.65 | 96.708 | 30.3 |
| 2 | Sherbimi II (Pneumologji) | 1838 | 18660 | 10.54 | 85.205 | 29.5 |
| 3 | Mjekesia Interne | 329 | 4144 | 12.59 | 75.689 | 21.93 |
| 4 | Kardiologjia + Hemodinamikas | 1722 | 4304 | 2.52 | 58.959 | 85.35 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Kardiokirurgjia | 432 | 4711 | 10.51 | 86.046 | 29.87 |
| 6 | Kirurgji e Pergjithshme | 973 | 5244 | 5.51 | 95.781 | 63.4 |
| 7 | Kirurgjia Torakale | 572 | 5284 | 7.41 | 72.384 | 35.65 |
| 8 | Reanimacioni | 210 | 3466 | 14.32 | 118.7 | 30.25 |
| **Totali** | | **7984** | **66992** | **8.38** | **86.16** | **37.46** |

**Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi"Njësia Kavajë**

| **Nr.** | ***Emertimi*** | ***Viti 2023*** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ***Gjithsej te hyre*** | ***Dite-paciente*** | ***Dite-qendrimi mesatar*** | ***Shfrytezim shtrati*** | ***Xhiro-shtrati*** |
| 1 | Sherbimi i Mjekese se Pergjithshme | 391 | 2109 | 5.42 | 28.89 | 19.45 |
| 2 | Sherbimi i Kirurgjise se Pergjithshme, Ortopedi-Traumatologjise, Urologjise | 45 | 309 | 6.87 | 3.26 | 1.73 |
| 3 | Sherbimi i Pediatrise | 655 | 3118 | 4.79 | 42.71 | 32.55 |
| 4 | Sherbimi i Obstetrike-Gjinekologjise | 146 | 814 | 5.61 | 11.15 | 7.25 |
| **Totali** | | **1237** | **6350** | **5.16** | **20.23** | **14.30** |

| **Nr.** | ***Emertimi*** | ***Viti 2024*** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ***Gjithsej te hyre*** | ***Dite-paciente*** | ***Dite-qendrimi mesatar*** | ***Shfrytezim shtrati*** | ***Xhiro-shtrati*** |
| 1 | Sherbimi i Mjekese se Pergjithshme | 677 | 2961 | 4.34 | 40.56 | 34.10 |
| 2 | Sherbimi i Kirurgjise se Pergjithshme, Ortopedi-Traumatologjise, Urologjise | 76 | 470 | 6.18 | 4.95 | 2.92 |
| 3 | Sherbimi i Pediatrise | 739 | 2647 | 3.57 | 36.26 | 37.10 |
| 4 | Sherbimi i Obstetrike-Gjinekologjise | 128 | 629 | 4.80 | 8.62 | 6.55 |
| **Totali** | | **1620** | **6707** | **4.11** | **21.37** | **18.97** |

| Nr. | Emertimi | *Viti 2025* | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ***Gjithsej te hyre*** | ***Dite-paciente*** | ***Dite-qendrimi mesatar*** | ***Shfrytezim shtrati*** | ***Xhiro-shtrati*** |
| 1 | Sherbimi i Mjekese se Pergjithshme | 575 | 2544 | 4.42 | 34.85 | 28.8 |
| 2 | Sherbimi i Kirurgjise se Pergjithshme, Ortopedi-Traumatologjise, Urologjise | 81 | 403 | 4.29 | 4.2 | 3.61 |
| 3 | Sherbimi i Pediatrise | 628 | 2208 | 3.52 | 30.25 | 31.4 |
| 4 | Sherbimi i Obstetrike-Gjinekologjise | 116 | 787 | 6.78 | 10.78 | 5.8 |
| **Totali** | | **1400** | **5942** | **4.29** | **18.93** | **16.44** |

**Indikatore kryesore Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njësia Tiranë**

| INDIKATORET | VITI 2023 | VITI 2024 | VITI 2025 |
|---|---|---|---|
| Dite mesatare | 8.9 | 8.1 | 8.4 |
| Shfrytezim shtrati | 86.9% | 91.7% | 86.2% |
| Xhiro shtrati | 35 | 41.3 | 37.5 |
| % e shtrimeve urgjente | 56% | 68.1% | 57% |
| BTI | 1.3 | 0.7 | 1.3 |
| Operacione vjetore | 1634 | 1769 | 1780 |
| Nr i shtreterve spitalor | 213 | 213 | 213 |
| Nr.i shtreterve ne urgjence | 23 | 23 | 23 |
| Rastet totale ne urgjence | 11,728 | 23,771 | 15,434 |
| Pacient te rinj te shtruar ne nje dite kalendarike | 21 | 24 | 22 |
| Nr. i pacienteve te hospitalizuar ne nje dite ne spital (gjendje) | 185 | 196 | 183 |

**Indikatore kryesore Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Njësia Kavajë**

| INDIKATORET | VITI 2023 | VITI 2024 | VITI 2025 |
|---|---|---|---|
| Dite mesatare | 5.16 | 4.1 | 4.2 |
| Shfrytezim shtrati | 20.2% | 21.3% | 18.9% |
| Xhiro shtrati | 14.3 | 18.9 | 16.4 |
| % e shtrimeve urgjente | | 95% | 92% |

| | | | |
|---|---|---|---|
| BTI | | 15 | 18 |
| Operacione vjetore | | 30 | 60 |
| Nr i shtreterve spitalor | 86 | 86 | 86 |
| Nr.i shtreterve ne urgjence | 4 | 4 | 4 |
| Pacient te rinj te shtruar ne nje dite kalendarike | 4 | 4 | 4 |
| Nr. i pacienteve te hospitalizuar ne nje dite ne spital (gjendje) | 14 | 18 | 16 |

**Sasia e materialeve të buta për larje:**

Materiali i butë që do të lahet nga operatori ekonomik grupohet në 2 (dy) kategori, në përputhje me Udhëzimin nr. 141, datë 08.03.2024, me Nr. 1334/1 prot., i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale, për përcaktimin e normativave të shërbimit të lavanderisë dhe standardizimin e uniformave të personelit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike me shtretër.Referuar këtij udhëzimi, në vijim janë të detajuar:

I. Llojet e materialit të butë që do të përdoren për çdo pacient

- Çarçafë shtrati (i poshtëm, i sipërm, zarf)
- Jorgan
- Këllëf dysheku
- Jastëk
- Këllëf jastëku
- Bizhame pacienti per adult dhe femije
- Rrobdishane pacienti per adult dhe femije
- Pantofla pacienti per adult dhe femije
- Peshqire
- Kompresa

II. Materiali i butë që do të përdoret nga personeli mjekësor.

- Uniforme per mjeke kirurge+reanimatore
- Uniforme per infermierin
- Uniforme per sanitare
- Perparese per mjeke
- Bluze me menge te gjata
- Perparese per farmaciste
- Uniforme per laborante
- Uniforme per prapavijen
- Pershqira per personelin

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të kryhet çdo tre ditë, ose dy herë në javë, sipas tabelës Shpeshtësia e ndërrimit të materialit të butë sipas shërbimeve/pavioneve, si dhe në çdo rast të kërkuar nga Kryeinfermieria, për shkak të shtrimit të pacientëve të rinj (hapja e kartelës klinike),

ose kur ndërrimi bëhet i domosdoshëm për të garantuar shëndetin dhe sigurinë e pacientit, në përputhje me rregulloren e brendshme për menaxhimin e procesit të lavanderisë. Në shërbime të veçanta, ky ndërrim mund të kryhet sa herë të jetë i nevojshëm, duke u bazuar në situatën konkrete të pacientëve dhe rekomandimet profesionale të stafit mjekësor.

Në tabelën në vijim, jepet e detajuar shpeshtësia e ndërrimit të çarçafëve, në disa prej shërbimeve në Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë dhe Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavajë

| Nr. | *Shërbimi* | *Shpeshtësia e Ndërrimit të Çarçafëve* |
|---|---|---|
| 1 | Kirurgjite | 1 x dite te operuarit; 1x3 ditë para operacionit dhe pas dites se dyte te operimit |
| 2 | Reanimacionet | 1 x ditë |
| 3 | Pneumologjite | 1 x 3 ditë |
| 4 | Kardiologjia dhe Hemodinamika | 1 x 3 ditë |
| 5 | Mjeksia Interne | 1 x 3 ditë |
| 6 | Pediatria | 1 x 3 ditë |
| 7 | Urgjenca | sa here te jete e nevojshme |

- **Baza materiale që duhet të ketë Operatori Ekonomik** *(Materiali i butë)*

Për të gjithë zerat e mëposhtem operatori ekonomik duhet të ketë një rezervë deri në 10%, për të siguruar vijueshmerine e punës mbas furnizimit brënda 60 ditëve të materialit të butë të ri.

| NR. | EMERTIMI | INVENTAR NE PERDORIM | KOMENTE |
|---|---|---|---|
| **1** | Dyshekë | 336 | Për të gjithë shtretërit |
| **2** | Kellefe dysheku | 430 | Për të gjithë shtretërit dhe 94 rezerve |
| **3** | Jasteke | 336 | Per cdo Shtrat |
| **4** | Kellef jasteku | 496 | Per cdo Shtrat |
| **5** | Çarçaf per shtratin i poshtëm | 744 | Per cdo Shtrat |
| **6** | Çarçaf per shtratin i sipërm | 496 | 15 Maj deri në 15 Shtator (periudha pranvere –vere) |
| **7** | Çarçaf zarf | 496 | Per cdo Shtrat. 16 Shtator -14 Maj (periudha vjeshte –dimer) |
| **8** | Jorgan | 336 | 16 Shtator -14 Maj |
| **9** | Robdishanët e pacientëve për Kirurgjinë e të rriturve | 100 | Per te gjitha kirurgjite |
| **10** | Pizhama pacienti | 200 | Per te gjithe pacientet e rritur |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **11** | Pizhama pacienti, per femijet e Pediatrise | 20 | Per te gjithe pacientet e Pediatrise |
| **12** | Pandofla pacienti për të rriturit | 50 | Per pacientet e rritur |
| **13** | Pandofla pacienti per Pediatrine | 20 | Per pacientet e pediatrise |
| **14** | Peshqire | 100 | Per pacientet |
| **15** | Peshqire | 100 | Per personelin |
| **16** | Kompresa | 300 | Per pacientet |

Gjithashtu, referuar Udhëzimit Nr. 141, datë 08.03.2024, me Nr. 1334/1 Prot., të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale, për "Përcaktimin e normativave të shërbimit të lavanderisë dhe standardizimin e uniformave të personelit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike me shtretër", sipas tabelës mëposhtme, operatori ekonomik duhet të plotësojë nevojat për inventar të veshjeve të personelit si vijon:

- Personelit mjekësor do t'i jepen uniformat me një normë zëvendësimi të përcaktuar në tabelë.
- Operatori ekonomik, nga momenti i lidhjes së kontratës, duhet të furnizojë me bazën materiale të specifikuar të gjithë personelin mjekësor, brenda një afati kohor të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

| **NR.** | **EMËRTIMI** | **INVENTARI NË PËRDORIM** | **FREKUENCA E ZËVENDËSIMIT** | **SASIA TOTALE NË VIT** |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Uniforme per infermierin (F) | 206 | 2-vit | 412 |
| **2** | Uniforme per infermierin (M) | 63 | 2-vit | 126 |
| **3** | Bluze me menge te gjata me zinxhir per infermier | 269 | 1 -vit | 269 |
| **4** | Uniforme per sanitare | 87 | 2-vit | 174 |
| **5** | Perparese per mjeke (F) | 47 | 2-vit | 94 |
| **6** | Perparese per mjeke (M) | 51 | 2-vit | 102 |
| **7** | Perparese per farmaciste (F) | 3 | 2-vit | 6 |
| **8** | Perparese per farmaciste (M) | 1 | 2-vit | 2 |
| **9** | Uniforme per laborante (F) | 13 | 2-vit | 26 |
| **10** | Uniforme per laborante (M) | 12 | 2-vit | 24 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **11** | Uniforme per prapavijen | 48 | 2-vit | 96 |
| **12** | Uniforme per mjeke kirurge+reanimatore | 25 | 2-vit | 50 |
| **13** | Pandofla salle | 50 | 1 -vit | 50 |
| **14** | Pandofla per infermiere | 269 | 1 here ne 2 vjet | 269 ne 2 vjet |

**Operatori i kontraktuar duhet të zevendesoje materialin e butë sipas tabelës në vijim:**

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia e blerjeve në vit | Jetëgjatësia |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Dyshekë | Copë | 336 | Kjo sasi do te furnizohet brenda 60 diteve pas nenshkrimit te kontrates brenda periudhes se MK. Ne rast se shfaqen demtime per shkak te prodhuesit e konstatuar nga AK dhe OE, ky i fundit do ti zevendesoje menjehere. |
| **2** | Këllef dysheku | Copë | 430 | Cdo vit |
| **3** | Jastëk | Copë | 336 | 1 herë në dy vjet |
| **4** | Këllëf jastëku | Copë | 496 | Cdo vit. |
| **5** | Çarçaf shtrati i poshtëm | Copë | 744 | Cdo vit |
| **6** | Çarçaf shtrati i sipërm | Copë | 496 | Cdo vit |
| **7** | Çarçaf zarf | Copë | 496 | Cdo vit |
| **8** | Jorgan vatine | Copë | 339 | Kjo sasi do te furnizohet brenda 60 diteve pas nenshkrimit te kontrates brenda periudhes se MK. Ne rast se shfaqen demtime per shkak te prodhuesit e konstatuar nga AK dhe OE, ky i fundit do ti zevendesoje menjehere. |
| **9** | Robdishane pacienti per kirurgjine e adulteve | Copë | 100 | Cdo vit. |
| **10** | Pizhama pacienti | Copë | 200 | Cdo vit. |
| **11** | Pizhama pacienti, per femijet e Pediatrise | Copë | 20 | Cdo vit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **12** | Pandofla pacienti per adultet | Palë | 50 | Cdo vit |
| **13** | Pandofla pacienti per Pediatrine | Pale | 20 | Cdo vit |
| **14** | Peshqire per pacientin | Copë | 100 | Cdo vit |
| **15** | Kompresa | Copë | 300 | Cdo vit |
| **16** | Peshqira per personelin | Copë | 100 | Cdo vit |
| **17** | Uniforme per infermierin (F) | Palë | 412 | Cdo vit |
| **18** | Uniforme per infermierin (M) | Palë | 126 | Cdo vit |
| **19** | Uniforme per sanitare | Palë | 174 | Cdo vit |
| **20** | Perparese per mjeke (F) | Palë | 94 | Cdo vit |
| **21** | Perparese per mjeke (M) | Palë | 102 | Cdo vit |
| **22** | Perparese per farmaciste (F) | Palë | 6 | Cdo vit |
| **23** | Perparese per farmaciste (M) | Palë | 2 | Cdo vit |
| **24** | Uniforme per laborante (F) | Palë | 26 | Cdo vit |
| **25** | Uniforme per laborante (M) | Palë | 24 | Cdo vit |
| **26** | Uniforme per prapavijen | Palë | 48 | Cdo vit |
| **27** | Bluze me menge te gjata me zinxhir per infermier | Copë | 269 | Cdo vit |
| **28** | Uniforme per mjeke kirurge+reanimatore | Palë | 18 | Cdo vit |
| **29** | Pandofla salle | Palë | 50 | Cdo vit |
| **30** | Pandofla per infermiere | Palë | 269 | 1 here ne 2 vjet |

Përzgjedhja e jorganëve me vatinë bën të domosdoshëm përdorimin e çarçafëve zarf. Gjatë sezonit të verës, lind nevoja për mbulim të shtratit vetëm me çarçafë të thjeshtë.

Në këto kushte, është parashikuar që:

Çarçafët zarf të përdoren për 8 (tetë) muaj të vitit;
Për periudhën 15 Maj – 15 Shtator të përdoren çarçafë të thjeshtë, pra për 4 (katër) muaj;
Si pasojë, çarçafët e poshtëm të shtratit do të përdoren gjatë gjithë vitit (12 muaj), çarçafët e sipërm për 4 muajt e verës, dhe çarçafët zarf për 8 muajt e tjerë.

Cilësojmë se i gjithë materiali që do të ripërtërihet, duhet të përmbaje logon dhe emërtimin e AK. Gjithashtu, edhe materiali i butë veshje personeli duhet të kete shenjat dalluese te AK.

**Specifikimet teknike te materialit te bute.**

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

| **Nr.** | **Emrtimi** | **Njsia** | **Specifikimet Teknike** | **Dimensionet** | **Materiali** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Çarçaf shtrati I poshtm | Cop | 160 – 180 gr/m2, Me qepje 20tanda katerta anet. Ngjyre e bardhe. | 170x270 cm | 75% pambuk x 25% polyester Lahet n temp 60° |
| **2** | Carçaf shtrati I siperm | Cop | 160 – 180 gr/m2 Me qepje 20tanda katerta anet. Ngjyre e bardhe. | 170x270 cm | 75% pambuk x 25% polyester, |
| **3** | Çarçaf zarf | Cop | 160 – 180 gr/m2 Dy fletsh, me qepje 21tanda tre anet, I çar ne fund per te mundesuar futjen e jorganit ne forme zarfi. Ngjyre e bardhe. | 220x160 cm | pambuk 100%, ngjyr e bardh, lahet n temp 90° |
| **4** | Kellef dysheku (mbules) | Cop | 280 – 300 gr/m2 Material pambuku, ngjyre e bardh, I qepur nga kater anet me llastik per t'u fiksuar tek dysheku spitalor. | 190 x 90. Lartesia 10 -15 cm (nga te kater anet) | Materiali i gomuar , I papërshkueshëm nga uji, Lahet në temperaturë te lartë |
| **5** | Jastek | Copë | Mbushje uniforme me fibra sintetike. Ngjyre e bardhe, me mbulese dyshe | 50x80 cm Pesha 1000gr | Mbushje me fibra sintetike |
| **6** | Kellef Jasteku | Copë | Nga njera ane ka nje te çar 21tandar, per te lejuar futjen e jastekut. Ngjyre e bardhe. 160 – 180 gr/m2. | 60x90 cm | 75% pambuk x 25% polyester |
| **7** | Jorgan I lehte vatine (njengjyrsh) | Copë | Me mbushje me vatine, me tegela ndarse ne forme kuadrati, ngjyre e bardhe. Veshja e jashtme e jorganit te jete pambuk. | 140x200 cm | Mbushje me fibra sintetike |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **9** | Robdisham Pacienti Adult | Copë | Me lidhje anash ose mbrapa, me meng te shkurtra , masat; M, L, XL, XXL,ngjyra sipas kerkeses se AK | 120 -150 cm | perberje 100% pambuku. |
| **10** | Robdisham Pacienti Pediatrik | Cope | Me lidhje anash ose mbrapa, me meng te shkurtra, masat; M, L, XL, XXL,ngjyra sipas kerkeses se AK | 60-110 cm | perberje 100% pambuku. |
| **11** | Komplete Pizhame pacienti Adult | Cope | Pambuk I plote xhaketa me krahe te gjate, me jake ose forme V. | Xhaketa 71 cm. | perberje 100% pambuku, me larje n temp 90 °. |
| | | | Pantallonat unisex me llastik ne bel, ngjyra sipas kerkeses se AK | Pantallona 120, +-5cm | |
| **12** | Komplete Pizhame pacienti Pediatrik | Cope | Pambuk I plote xhaketa me krahe te gjate, me jake ose forme V. | Xhaketa 30-60 cm. | prbrje 100% pambuku, me larje n temp 90 °. |
| | | | Pantallonat unisex me llastik ne bel, ngjyra sipas kerkeses se AK | Pantallona 40 -90 | |
| **13** | Pandofla pacienti Adult | Copë | Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gomë poroze me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. | Numrat nga: 37 – 43 | Materiali të jetë plastik, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji |
| **14** | Pandofla pacienti Pediatrik | Copë | Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gomë poroze me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.. | Numrat nga: 23 – 36 | Materiali të jetë plastik, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji |
| **15** | Pandofla Personeli | Copë | Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gomë poroze me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të | Numrat e pandoflave sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. | Materiali të jetë plastik, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. | | padepërtueshëm nga uji |
| **16** | Pandofla Personeli (Për sallat e operacionit) | Copë | Pandofla për përdorim në sallat e operacionit, material plastik, me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së AK. | Numrat e pandoflave sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. | Materiali të jetë plastike, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji |
| **17** | Peshqir (pacienti, personeli, urgjence, kabineti) | Copë | Material pambuku I bute ngjyre e bardhe. | 90x60 cm | pambuk 100% |
| **18** | Kompresa | Copë | Material pambuk me ngjyre te bardhe, materiali kabot. | 100 x100 cm | pambuk 100% |
| **19** | Dyshek Spitalor | Copë | Ortopedik, te njetrajtshme (Pa ndarje), me dy shtresa vatine te fort, ku njera ane te kete porozitet per qarkullimin e ajrit, jo me susta, injifugo (kunder zjarrit) dhe me mbulese te fort (mushama) antibakteriale, antialergjike. | 200x90xH15 cm | Veshja e dyshekut me mbules (mushama) te padeprtueshme nga uji apo lengjet biologjike. |
| **20** | Perparese Mjeku unisex | Copë | Material Pambuku, ngjyre e bardhe, ku ne te majte ka nje xhep te vogel te drejte dhe do te vendoset logoja e spitalit. Densitetin e thurjes 230 gr/m². Gjatesia e perpareses standarte, me meng te gjata, (pjesa e mbrapme me nje te çar per burrat per te lejuar levizjen), dhe perpara te jete me kopsa ose me perçina, si dhe me dy xhepa pllake poshte. | Gjatesia e perpareses, sipas standartit S,M,L,XL, X,XL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester |
| **21** | Kostume Infermieri | Copë | **Bluza** me jak V te trash me xhep te vogel larte majtas, ku te shenohet logoja e spitalit. Me meng te shkurtra te gjera dhe me dy xhepa anesor poshte bluzes. | Sipas standartit S,M,L,XL, XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Pantallona unisex,** me llastik ne pjesen e belit, me ose pa xhepa ne pjesen e perparme. **Ngjyrat** sipas kerkeses se autoritetit kontraktor.<br>**Densiteti I thurjes** 130-160 gr /m² | Gjatsia e bluzes 71 cm, gjatsia pantallonit standard, toleranc +- 2 cm. | |
| **22** | Kostume Sanitare | Copë | **Bluza** me jak V te trash me xhep te vogel lart majtas. Me meng te shkurtra dhe te gjera, me dy xhepa anesor posht bluzes. | Sipas standartit S,M,L,XL, XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester |
| | | | **Pantallona unisex,** me llastik ne pjesen e belit, me ose pa xhepa ne pjesen e perparme. **Ngjyra** sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. | Gjatsia e bluzs 71 cm, gjatsia pantallonit standard, toleranc +- 2 cm. | |
| **23** | Bluze me menge te gjata me zinxhir | Copë | Material 100% poliestër 260gr/m². me mengë të gjata. me dy xhepa . Me zinxhir. | (S,M,L,XL, XXL) | Materiali 100% poliestër |
| **24** | Kostume Personeli Ndihmes | Copë | **Bluza** me jak V te trash me xhep te vogel lart majtas. Me meng te shkurtra dhe te gjera, me dy xhepa anesor poshte bluzes. | Sipas standartit S,M,L,XL, XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester |
| | | | **Pantallona unisex,** me llastik ne pjesen e belit, me ose pa xhepa ne pjesen e perparme.<br>**Ngjyra** sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. | Gjatsia e bluzes 71 cm, gjatesia pantallonit standarte, toleranc +- 2 cm. | |

**<u>SHENIM:</u>**

- Specifikimet teknike do te zbatohen ne baze te Udhezimit Nr.141 date 08.03.2024 me Nr.1334/1 Prot date 08.03.2024 “Per percaktimin e normativave te sherbimit te lavanderise dhe standartizimit te uniformave te personelit shendetesor ne institucionet shendetesore publike me shtreter”.
- Materialet të jenë shoqëruara me çertifikatë analize dhe me stampim logon AK.

- Materialet ti përgjigjen standarteve STASH në fuqi dhe standarteve europiane CE.
- Operatori Ekonomik duhet të plotesojë kushtin teknik paraqitjen e mostrave për çdo artikull.
- Mbasi te jete lidhur kontrata me OE dhe gjate procesit te marrjes ne dorezim te bazes materiale do te ngrihet nje komision i cili duhet te beje peshimet e te gjithe zerave te mesiperm per te saktesuar peshen e ketyre materialeve. Ky proces duhet te behet ne prezencen e OE dhe do te firmoset ng ate dyja palet. Peshat e bazes materiale do te perdoren ne fund te cdo muaji per llogaritjen e kg dhe faturimin mujor.

**Specifikimet teknike te Menaxhimit te Procesit te Lavanderise**

Operatori ekonomik do te ofroje sherbimin e tij, nga procesi i lavanderise deri tek kompletimi me inventarin e materialit te bute te shtratit te pacientit.

Operatori Ekonomik eshte i detyruar te disponoje te gjitha kapacitetet larese dhe dezinfektuese, tharese, hekurosese dhe paketuese. Pervec kesaj, Operatori Ekonomik duhet te siguroje per zevendesimin e materialit te bute, nese eshte i demtuar apo i amortizuar (sipas kohes se tyre te amortizimit).

Operatori Ekonomik siguron inventarin e materialit te bute te nevojshem, per nje kompletim te rregullt sipas normave te shtratit te percaktuara nga Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe ne Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje, me emertimin/siglen perkatese te institucionit kontraktues. Inventari i materialit te bute, ne kuptimin e kesaj kontrate, emertimi, permasat, dimensionet, cilesia dhe normat e perdorimit ne kohe, do te perfshihen ne specifikimet perkatese.

Operatori Ekonomik do te laje, dezinfektoje, thaje, paketoje te transportoje dhe shperndaje deri ne pavion bazen e materialit te bute si dhe te beje sherbimin e plote deri tek shtrati i pacientit.

Rregullat e shtrimit te shtratit do te behen sipas protokolleve te kujdesit infermieror, manualit te kujdesit spitalore, rregullave te higjenes me njoftimin e hapjes se karteles se re te shtrimit nga K/infermieri i sherbimit si dhe sa here nevojitet nga sherbimi.

Larja dhe dezinfektimi, ne repartin e lavanderise do te behet ne menyre te perqendruar, duke respektuar te gjitha procedurat dhe protokollet e higjenes, nga marrja ne dorezim e materialit te bute te papaster te ndare sipas nendarjeve dhe zonave te rrezikshmerise (thaset me ngjyre), tek dorezimi i materialit te bute, te lare, te hekurosur dhe te paketuar sipas ketyre protokolleve, deri ne shtrimin e shtratit te pacientit sipas protokolleve infermierore. Pjese e ketij procesi eshte edhe sigurimi i pastrimit te plote kimik-mekanik, ne temperaturat e duhura, dhe i procesit te hekurosjes.

**Larja** e inventarit te materialit te bute, do te behet me keto afate:

- Carcafet, kellefet e jastekut, kellefet e dyshekut, rrobdishanet e pacientit, pizhamet e pacientit, peshqiret e pacientit, do te lahen 2(dy) here ne jave, referuar tabeles shpeshtesia e nderrimit te carcafeve sipas sherbimeve/pavioneve, si dhe në çdo rast që kërkohet nga

kryeinfermieri i pavionit/shërbimit, per cdo shtrim te ri, si dhe sa here te jete e nevojshme nga sherbimi.

- Jorganet e vatines, kellefet e dyshekut dhe jasteket, do te lahen ne çdo shtrim te ri dhe sa here te jete e nevojshme nga sherbimi.
- Kostumet josterile te sallave te operacionit, do te lahen ne baze te operacioneve qe kryen sherbimi.
- Perpareset e mjekut, kostumet e personelit infermieror, personelit ndihmes, te sanitareve do te lahen 2 (dy) here ne jave. si dhe sa here te jete e nevojshme.
- Peshqiret e personelit shendetesor, do te lahen 2 (dy) here ne jave, si dhe sa here te jete e nevojshme nga sherbimi.
- Pandoflat do te lahen 1 (një) here ne javë dhe sa herë të jetë e nevojshme .

**Nderrimi i materialit te bute te shtratit, do te behet me keto afate:**

- Carcafe shtrati i siperm dhe i poshtem, carcaf zarf, kellef jasteku, kellef dysheku, peshqire pacienti, rrobdishan pacienti, pizhame pacienti, do te nderrohen jo me pak se 2(dy) here ne jave per cdo shtrat, per cdo shtrim te ri, si dhe sa here kerkohet nga sherbimi.

*Terheqja dhe dorezimi i inventarit te materialit te bute ne pavione, do te behet me grafik te hartuar nga Personi pergjegjes i ngarkuar me kete detyre ne Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje. Grafiku eshte i detyruar te zbatohet nga te dyja palet, dhe ne rastet e ndryshimit te tij, miratimi duhet te behet me nenshkrim nga te dyja palet.*

*Perdorimi i inventarit te materialit te bute brenda pavionit, behet dhe mbetet nen pergjegjesine e personelit te Operatorit Ekonomik te kontrolluar nga Autoriteti Kontraktor, sipas procedurave te meposhtme:*

**Etapat e ketij procesi cdo dite:**

- Çdo ditë, Kryeinfermieri harton forcën ditore totale per diten e neserme per material te bute dhe brenda orës 13:30 e dorezon pranë Sektorit te hotelerise.
- Sektori i hotelerise, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore dhe ia dorëzon Operatorit Ekonomik për zbatim.
- Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me mirëkuptim të Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe ne Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje. Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse AK konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtimit të profesionit të tij.
- Punonjësit duhet të sillen me edukatë dhe kortezi, si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e materialeve nëpër pavione, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.
- Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit të infeksioneve nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për të shmangur infeksionet), deri në shtrimin e shtratit të pacientit në të gjitha shërbimet e Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe te Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje:
- Operatori ekonomik siguron invenatrin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje, me emërtim dhe siglën përkatëse për secilin artikull: këllëf dysheku, jastëk, këllëf jastëku, çarçaf shtrati i poshtëm, çarçaf shtrati i sipërm, çarçaf zarf, jorgan vatine, pizhame pacienti, pandofla pacienti dhe personeli, kostumet e sallës, peshqirë, përparëse mjeku, triko mejku/infermieri, kostume infermieri, sanitare, etj.
- Shpërndarja e materialit të butë në të gjithë shërbimet e Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje, do te kryhet sipas grafikëve të përcaktuar nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara nga ora 7:00 deri ne oren 15:00.
- **Procesi i marrjes në dorëzimi i inventarit në pavion, do të** bëhet me dokument të rregullt të nënshkruar nga k/infermjeri/ja i/e pavionit ose personi i autorizuar prej tij, pas numërimit, kontrollit për hekurosjen, cilësinë e materialit të butë të larë në lavanderi (në bazë të kërkesës të sjellë një ditë mëparë në sektorin e hotelerisë). Ky dokument (proçes-verbal) duhet të jetë në tre kopje, të miratuar nga ‘’Autoriteti Kontraktor’’ dhe ‘’Sipërmarrësi’’. Ky dokument ka vlerë financiare.
- Shtrimi i shtratit te pacientit ne pavion, si per shtrimet e reja ashtu edhe shtrimet urgjence, nga ora 15:00 deri ne oren 07:00 te mengjesit te dites se neserme do te jete nen pergjegjesine e personelit te Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe te Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje.
- Terheqja e materialeve te ndotura nga pavioni, do te behet nga sipermarresi deri ne oren 15:00, duke iu referuar “Rregullores per parandalimin e infeksioneve spitalore”.
- Në rast të dëmtimit / konstatimit te mungesave te materialit te bute, per periudhen e lene nen administrimin e personelit te Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe te Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje, do te mbahet nje proces-verbal, i cili do te firmoset nga te dyja palet, nje kopje e te cilit do te dorezohet ne sektorin e hotelerise dhe sipermarresi do te beje menjehere zevendesimet perkatese dhe me pas do te behet zhdemtimi ne vlere nga ana e AK

- Kryeinfermieri i pavionit do të evidentojë dhe konfirmojë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimet që kryhen, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do informojë Sektorin e Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.
- Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevojë për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të Sektorit të hotelerise, Operatori Ekonomik do të proçedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë të kërkuar nga shërbimi, pas miratimit të Sektorit të hotelerise te AK.
- Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që vendos Drejtoria e Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi".
- Riparimi i inventarit të dëmtuar, bëhet nga Operatori Ekonomik duke ruajtur përmasat, dimensionet dhe përbërjen fillestare.
- Operatori Ekonomik do të largojë vetë mbetjet urbane që gjenerohen gjatë ofrimit të shërbimit.
- AK do të vendosë në përdorim ambjentin e lavanderisë, ku Operatori Ekonomik mund të ushtrojë aktivitetin e shërbimit të lavanderisë. Ky mjedis nuk mund të tjetërsohet.
- Për ambjentin Lavanderi, OE do te paguaje qerane sipas ligjeve ne fuqi. Kur janë të nevojshme të bëhen përshtatje ne ambjentin lavanderi, për shkaqe teknologjike, do te merret miratimi me shkrim nga AK. Ndersa ambjentet ndihmese ne sherbime/pavione te Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" do te jepen ne perdorim dhe do te mirembahen nga OE.
- Te gjitha kostot per ofrimin e sherbimit te lavanderise dhe hotelerise ne Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe ne Qendren Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje, jane pergjegjesi dhe do te sigurohen nga vete Operatori Ekonomik.
- I gjithë inventari i materialit të butë të marrë në përdorim nga Opertaori Ekonomik, me përfundimin e kontratës do i dorëzohet Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje, me proçesverbale pa kundërpagesë.
- Maredheniet financiare midis paleve, do te percaktohen ne momentin e lidhjes se kontrates.

Inventari i butë i shtretërve të pacientëve dhe veshjet e personelit mjekësor do të jenë në ngarkim të sipërmarrësit dhe do të administrohen prej tij deri në përfundim të kontratës së shërbimit. Me përfundimin e kontratës, i gjithë inventari i butë do t’i kalojë në administrim Spitalit.

**Shtojca 9**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: "Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi"**

| **Shërbimi** | **Përshkrimi** | **Shuma totale për 48 muaj** | **Vendi i ekzekutimit** | **Afati i ekzekutimit** |
|---|---|---|---|---|
| Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi | Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës | 672,103.36 kg | Në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" | Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër |

**Afatet e ekzekutimit:** 48 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës.

**Shtojca 10**

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”**

Me qëllim: Kryerja e Shërbimit të Lavanderisë dhe Hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tiranë dhe Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavajë’

**Rregullat per Qarkullimin e materialit te Bute ne pavionet e** Qendres Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendrës Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje**, per parandalimin, eliminimin e infeksioneve Spitalore.**
Rregullat per eleminimin e infeksioneve spitalore, mbeshteten ne manualet e kujdesit spitalor, ne manualet e parandalimit te infeksionit nozokomial, ne rregullat e higjenes, ne ligjin e inspektoriatit sanitar shteteror, ne protokollet e kujdesjeve infermierore si dhe ne praktikat me te mira te spitaleve te bashkimit europian, ne sherbimin dhe kujdesin spitalor.

**Pershkrimi:**
Personeli i sipermarresit, qe kryen procedurat si ne shtrimin e shtratit te pacientit ashtu dhe ne terheqjen e materialeve te ndotura, duhet te kete veshje identifikuese, te njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet te zbatoje protokollin e kujdesit infermieror ne shtrimin e shtratit te pacientit, si dhe rregullat e higjenes.

Ndarja e materialeve behet mbas cdo nderrimi te shtratit, gjate procesit te larjes apo kujdesit ndaj pacientit.

Materiali i bute duhet te manipulohet me doreza josterile nje perdorimshe, ai nuk duhet transportuar duke e mbajtur ne dore nga personeli apo lene ne toke.

Mbledhja e materialeve te papastra, do te behet ne nje vend te percaktuar nga sherbimi, autoriteti kontraktor, ne thaset identifikues me ngjyren dhe siglen perkatese te llojit te llojit te materialit te ndotur, te cilet do te qendrojne aty deri ne momentin e dorezimit.

Thaset e rrobave mbushen deri ne 2/3, mbyllen krejtesisht dhe vendosen ne dhomen apo vendin e parashikuar ne sherbim per depozitimin e materialeve. Evakuimi duhet te behet sa me shpejt te jete e mundur.

Thaset nuk duhet te terhiqen mbi dysheme.

Karroca e materialeve, sherben per mbajtjen e thaseve me ngjyra, per depozitimin e materialeve te ndotura nga nje shtrat ne tjetrin. Karroca eshte e paisur me rrota dhe e ndare me thaset specifike me ngjyre me siglen perkatese identifikuese.

Karroca e materialeve, nuk futet ne dhomen e te semurit. Ne momentin e nderrimit te pacientit, largo cdo objekt duke bere kujdes per aparatet dentare, auditiv, stilolaps apo tjeter material preres.

Operatori Ekonomik terheq nga pavioni inventarin e mbyllur me thaset me ngjyra te percaktuara sipas zonave dhe normave higjeno-sanitare, per larje dezinfektim nga personi i autorizuar klinika-k/infermieri/ja, dhe ne te njejten kohe dorezon ne pavion inventarin e paster te hekurosur dhe te paketuar. Inventari qe merret ose dorezohet, eshte gjithmone i palosur dhe i paketuar.

**Veshjet e punes se personelit shendetesor:**
Veshjet e personelit shendetesor te ndotura, me xhepat e zbrasur vendosen ne thesin qe ndodhet tek dhoma e zhveshjes se personelit.

**Rast i vecante i materialit te kontaminuar "me rrezik mikrobiologjik":**
Ky material vendoset fillimisht ne nje qese plastike dhe me pas ne nje thes rrobash te verdhe: material i kontaminuar me gjak apo lengje biologjike.
E njejta procedure do te zbatohet edhe per materialin e kontaminuar (salmonela, shigela, viruse intestinale, chlostridium difficile) apo kur vihet re prania e ekto paraziteve si cimka, morra etj.

**Rast i vecante i materialit te kontaminuar nga nje pacient pas ekzaminimit ne mjeksine nukleare:**
Vendosni materialin e kontaminuar ne qese plastike, ruajeni ne tualetin e pacientit, lajmeroni sherbimin e radiombrojtjes (nepermjet QKU), per te kostatuar nivelin e uljes se radioaktivitetit, perpara eleminimit ne nje thes te verdhe.
Materialet e tjera do te vendosen ne thes blu, me siglen **"material i piset".**

**Qarkullimi:**
Mledhja e materialit te ndotur kryhet nga nje punetor/sanitar i sherbimit cdo mengjes.
Shperndarja e materialit te paster per hospitalizim dhe veshjet e punes, behet ne cdo sherbim nga personeli i autorizuar nga sipermarresi.
Ne asnje rast materialet nuk hidhen nga sherbimet.

**Perkujdesje:**
Lani duart ne cdo nderrim shtrati nepermjet kesaj procedure: kryeni nje larje te thjeshte dhe me pas nje ferkim hidroalkolik te duarve, pasi te keni manipuluar me materialet e pista.

Lani cdo dite karrocat e mbajtjes se thaseve te materialit te ndotur, mos lani asnjehere materialet ne sherbim, si dhe mos merrni asnjehere material per t'a lare ne shtepi.

Shperndarja: Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje'

Vendi dhe dorezimi i sherbimeve: Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tirane dhe Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Kavaje.

**Shtojca 11**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

**OFERTUESI DEKLARON SE:**

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 12;***

*b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 5;***

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 11 të DST.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara**.**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B "Pastrim kimik", lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi "Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit", ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 23 (njëzet e tre) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| NR. | Stafi | Nr. |
|---|---|---|
| **1** | Përgjegjës Shërbimi | 2 (dy) |
| **2** | Punonjës në Lavanderi | 10 (dhjetë) |
| **3** | Punonjës Shërbimi në pavione | 9 (nëntë) |
| **4** | Shofer | 2 (dy) |
| | **Totali i punonjësve** | 23 (njëzet e tre) |

a) Përgjegjësi i shërbimit, duhet të jetë profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi/ duke përfshirë edhe kualifikime të tjera ekuivalente, dhe duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 1 (një) vit.

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- Diplomë e arsimit të lartë;
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e –albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekpseriencën e kërkuar.

b) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

c) Për punonjësit në pikën 4 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse dhe leje drejtimi për mjetet e kërkuara.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

| Nr | Emri i mjetit | Njësia | Sasitë minimale |
|---|---|---|---|
| 1 | Makinë larëse profesionale min 40 kg | copë | 3 (tre) |
| 2 | Makineri Barriera larese profesionale min 50 kg | copë | 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | Makinë larëse me disa dhoma larjeje min 100 kg | | 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, |
| 4 | Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 50 kg secila) | cope | 3 (tre) |
| 5 | Makineri hekurosëse (rul) profesional | cope | 2 (dy) |
| 6 | Makineri paketimi profesionale për paketim rrobash | Cope | 1 (një) |
| 7 | Karroca të shpërndarjes së materialeve | Cope | 7 (shtatë) |
| 8 | Makineri për larjen dhe dezinfektimin e karrocave | Cope | 1 (një) |
| 9 | Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet te jete kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese (Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise) | Cope | 2 (dy) |

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.7 Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë të përcaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme:

| | | | | QSRSHN |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emertimi i produktit | Vendi i origjinës | Skede teknike/katalog | Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar |
| 1 | Çarçaf shtrati i poshtem | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Çarçaf shtrati i siperm | | | |
| 3 | Carcafi zarf | | | |
| 4 | Kellef dysheku (mbulues) | | | |
| 5 | Jastëk | | | |
| 6 | Këllëf jastëku | | | |
| 7 | Jorgane I lehtë vatine (njëngjyrësh) | | | |
| 8 | Robdishan pacienti Adult | | | |
| 9 | Robdishan pacienti pediatrik | | | |
| 10 | Komplete pizhame pacienti adult | | | |
| 11 | Komplete pizhame pacienti pediatrik | | | |
| 12 | Pandofla pacienti adult | | | |
| 13 | Pandofla pacienti pediatrik | | | |
| 14 | Pandofla personeli | | | |
| 15 | Pandofla personeli (për salat e operacionit) | | | |
| 16 | Peshqire (pacienti, personeli, urgjence, kabinetit) | | | |
| 17 | Kompresa | | | |
| 18 | Dyshek spitalor | | | |
| 19 | Përparëse mjeku unisex | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 20 | Kostume infermieri | | | |
| 21 | Kostume sanitare | | | |
| 22 | Bluzë me mëngë të gjata me zinxhir | | | |
| 23 | Kostume personeli ndihmës | | | |

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta "me ndotje spitalore" sipas klasifikimit ne Termat e References shtojca 10 e DST:

-Material i kontaminuar"
-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.
-Material i konsideruar "me rrezik mikrobiologjik"
-Material i pisët"

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta "me ndotje spitalor"
III. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

| Materialet e pastrimit | | | | QSRSHN |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emërtimi i produktit që do të lahet** | **Vendi i origjines së produktit të pastrimit** | **Lloji/Emertimi I detergjentit** | **Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar** |
| 1 | Material i kontaminuar | | | |
| 2 | Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik” | | | |
| 4 | Material i pisët” | | | |

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion qe i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.10 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.**

**Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.**

**Shtojca 12**

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------ |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | ---------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: |

| |
|---|
| etj.<br><br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br><br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________<br><br>______________________________________________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>_________________________________________________________________________ |
| Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________ |

| |
|---|
| |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________<br><br>________________________________________________________________________<br><br>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________ |

**B: DEKLARATA "Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura"**

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se**:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër[8].

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

a) çmimet;
b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

[8] *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

**C: DEKLARATA "Mbi Konfliktin e Interesit"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br><br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br><br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:<br><br>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.<br>- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.<br>- Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).<br><br>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit**.<br><br>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". |

| |
|---|
| Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu. |

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: |
| • Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* __________________________________________________ |

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimittë objektit të kontratës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)"**

| Deklarata | Përgjigje |
| --- | --- |
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | Punonjës<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>Profili i punonjësve<br><br>__________________________________________<br>_<br><br>Makineri e mjete<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| **Emri, Mbiemri_______________**<br><br>**Firma ______________________**<br><br>**Vula_________________________**<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës ________________** | |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- **Në procedurat e prokurimit me një faze, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.**

- **Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.**

- **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.**

- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**

- **Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

**Shtojca 13**

**Formulari i Njoftimit të Skualifikimit**[9]

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit te njoftimit te fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

________________________

[9]*Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore*

**Shtojca 14**

**[***Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor***]**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**Data**

**Drejtuar:**

**Operatorit Ekonomik (OE)** ☐_____**ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**-** ***OE/BOE*** **me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** ☐ **JO** ☐

*Nëse po, të jepen dhënat*: ________________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:________________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:________________

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*______

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.____________________________________ ____________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat*__________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.___________________________________ ___________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Etj.____________________________________________________________________________________

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat*__________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.____________________________________ _______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera _______________________________ totali i pikëve të marra_________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat*__________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.________________________________ ___________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ___________________________ totali i pikëve të marra_______________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.________________________________________________________________________

* * *

**Lista e operatorëve ekonomikë të skualifikuar:**

1.________________________________ ______________ __________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.________________________________ ____________ __________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____________ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**Shtojca 15**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data]*

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)** □_____**ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* _______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat*: _______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:________________

Lloji i Procedurës së prokurimit:___________

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: ____________________________

[10]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *[Data] [Numri]*____________________________

[10] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Etj.

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1.______________________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________ totali i pikëve të marra________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it* Vlera

Vlera ______________________________ totali i pikëve të marra________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.

**Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:**

1.__________________________________ ________________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO □ JO□

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]**

**Shtojca 16**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**Data**

**Drejtuar:**

**Operatorit Ekonomik (OE)** ☐_____**ose**
[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐
*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** ☐ **JO** ☐

*Nëse po, të jepen dhënat*: ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

* * *

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:________________

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*______

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*
OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.______________________________

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues:**

1.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave_________________________________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave__________________________________(*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>Nëse po,</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.____________________________

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit e mëposhtëm:**

1.__________________________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>Nëse po,</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ _________________ _______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>Nëse po,</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

**Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i suksesshëm:**

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave___________________________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>Nëse po,</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave _______________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

Etj.______________________________

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**Shtojca 17**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data]*

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE) □ ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) □**

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO* □ *JO* □**

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO □ JO □**

*Nëse po, të jepen dhënat*: ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit (___________________________

[11]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit, *[Data] [Numri]*___________________________

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

[11] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.____________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* __________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.____________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* __________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.______________________________

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues:**

1.____________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave_________________________________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* __________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.____________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave_________________________________________________________________________
*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.____________________________

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit e mëposhtëm:**

1.__________________________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ _________________ _______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

**Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:**

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave_____________________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

2._________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave ______*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO 

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________
Etj.________________________________

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [*emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor* ] brenda ____________ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO  JO 

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]**

**Shtojca 18**

*(Shtojce për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*)

**FORMULARI I ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri__________________
Adresa_________________
Tel/Faks__________________
E-mail_________________
Ueb-faqe_________________

**2. Lloji i procedurës: ____________________**

**3. Numri i Referencës së procedurës/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës ________________________________________________________**

**5. Fondi Limit________________________________________________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

☐*në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
☐*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
☐*konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
☐*për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*
☐*kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;*
☐*kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP*

**7. Informacion shtesë**

_________________________________________________________________________________
_________________________________________________________________

Me publikimin e këtij formulari, nisin afatet e ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të Ligjit 162/2020 "Per prokurimin publik", të ndryshuar.

**Seksioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

Ky Seksion përmban :

Shtojca 19: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 20: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 21: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 22: Draftmarrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 23: Draftmarrëveshja kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 19

# Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1.1 Kontrata**

**1.1.1.1** “Kontrata” do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** “Çmimi i Kontratës” do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

**1.1.1.4** "Përfundimi” do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

**1.1.1.5** “Ndërprerje e Kontratës” do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

**1.1.1.7** "Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**1.1.1.8** “Listat” do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

**1.1.1.9** “Ofertë” do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**1.1.2 Palët e Kontratës**

1.1.2.1 “Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 “Blerës” do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.

1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

**1.1.3 Llogaritja e afateve**

1.1.3.1 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Shërbimet**

1.1.4.1 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

1.1.5.1 "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

1.1.5.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20“Forca Madhore”.

1.1.5.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 “Sigurimi i Kontratës”.

1.1.5.4 “Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

1.1.5.5 “E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës .

1.1.5.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

1.1.5.7 “Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

1.1.5.8 "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

1.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

**1.2.3 Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

**1.2.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

**1.3 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

**1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

**1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

**1.6 Hartimi i Kontratës**

**1.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**1.6.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

**1.7 E drejta e autorit**

**1.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

**1.8 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

### 1.9 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

### 1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

### 1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

**2.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**2.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3 Njoftimet**

**3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**3.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4 Objekti i Furnizimit**

**4.1** Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5 Dorëzimi**

**5.1** Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

**6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

**7.1** Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuara në përgjithësi.

**7.2** Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

**7.3** Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

**7.4** Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 8**

**Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

**8.1** Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

**8..2** Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

**8.3** Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Çmimi i Kontratës**

**9.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.1.

**Neni 10 Kushtet e Pagesës**

**10.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

**10.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

**10.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

**10.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 11 SIgurimi i Kontratës**

**11.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

**11.2** Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

**11.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

**11.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 12 Nënkontraktimi**

**12.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

**12.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për shërbimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

**12.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 13 Specifikime dhe Skicime**

**13.1** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

**13.2** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**14.1** Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

**14.2** Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shrbimeve që po sigurohen.

**Neni 15  Dëmet e likujduara**

**15.1** Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 16  Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

**16.1** Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.

**16.2** Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

**16.3** Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

**16.4** Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

**Neni 17 Zhdëmtimi i Patentës**

**17.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton  Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në  datën e kontratës për shkak të:

(a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

**17.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

**17.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

**Neni 18 Kufizimi i Përgjegjësisë**

**18.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 19 Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

**19.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 20 Forca madhore**

**20.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**20.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**20.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 21 Modifikimi i Kontratës**

**21.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**21.2** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

**21.3** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 22 Zgjatja e afatit**

**22.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

**22.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 23 Ndërprerja e Kontratës**

**23.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**23.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**23.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**23.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**24.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**24.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Shtojca 20**

# Kushtet e Veçanta të Kontratës

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

**Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**

**1.1** Bleresi është: ***[vendos emrin e Blerësit ]***

Adresa: ________________________________________________________________

Telefoni: _______________________________________________________________

Numri i faksit: ___________________________________________________________

E-mail: ________________________________________________________________

**1.2** Furnizuesi është: ***[vendos emrin e Furnizuesit]***

Adresa: ________________________________________________________________

Telefoni: _______________________________________________________________

Numri i faksit: ___________________________________________________________

E-mail: ________________________________________________________________

*Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës*.

**1.3** Gjuha për komunikimet është ***[specifiko gjuhën për komunikime]****:*

Gjuha është: ***[specifiko gjuhën]***

**Neni 2 Sigurimi i Kontratës**

**2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së saj) duhet të ofrohet nga Furnizuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**2.2** Monedha do të jetë: [specifikoni monedhën]

**2.3** Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Furnizuesit sipas formularit të mëposhtëm

**2.4** Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: ________________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, sigurimi mbetet i pandryshuar.

**Neni 3 Vendodhja e Shërbimeve**

Shërbimet do të kryhen në:_____________________________

**3.1**

**Neni 4 Informacion që duhet dhënë nga Blerësi**

**4.1** Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Blerësi duhet t'i japë Furnizuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

## Neni 5 Kërkesat e Raportimit

**5.2** Gjatë zgjatjes së kontratës, Furnizuesi duhet të sigurojë raporte për Blerësin sipas formularit të mëposhtëm: ____________________________________________________________________________________

**Neni 6 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**6.1** Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin/entin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: ____________________________________________________________________________________

**Neni 7 Çmimi i Kontratës**

Çmimi i Kontratës është: _________________________

**Neni 8 Kushtet e pagesës**

8.1 (a) Pagesa për Shërbimet do të bëhet brenda _________ ditëve nga data e pranimit të Shërbimeve ose nga data e marrjes së kërkesës për pagesë me shkrim, pavarësisht nga dita e ardhjes. Nëse nuk specifikohet, periudha kohore do të jetë 30 ditë

(b) Pagesa do të bëhet në monedhën______. Nëse lihet e paplotësuar, pagesa do të bëhet në monedhën . Shqiptare.

**8.2** Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

**_Neni 9 Garancia**

Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:

**Shtojca 21**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit/enti kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit /entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 22**

# Draft i Marrëveshjes Kuadër Ku përcaktohen të gjitha kushtet

**SHËRBIME**

[Përdorimi i kësaj drafte marrëveshje është i detyrueshëm për të gjithë autoritetet/entet kontraktore që do të përdorin Marrëveshjen Kuadër]

**Nr . __**
**datë :**

Kjo Marrëveshje është lidhur më [datë] ndërmjet [emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor], këtu e tutje referuar si "Autoriteti /Enti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktorit] përfaqësuar nga [përfaqësuesi], këtu e më tej referuar si "Kontraktori ".

Kontraktori, përmes ofertës së tij, me datë [data] pajtohet të kryejë shërbimin, siç specifikohet në kushtet e përcaktuara në:
-Këtë Formular;
-Formularin e Deklarimit të Ofertës të paraqitur nga Ofertuesi;
-Specifikimet Teknike;
-Listën e Çmimeve sipas elementeve përbërës të shërbimit.

Të gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura, si pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i Marrëveshjes Kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e shërbimeve të mëposhtme.

[ Përshkrim i përgjithshëm ]

1.2 Marrëveshja Kuadër do të zbatohet duke dërguar ftesa për oferta tek Operatorët Ekonomikë, palë në marrëveshje sipas nevojave të Autoritetit/entit kontraktor.

1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin/Entin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime në çmimet për njësi, për shembull nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara të specifikuara dhe / ose nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të mos blejë cilëndo nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:_______________________________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për shërbime përshkruhen në Listen e Çmimit të Shërbimeve.

2.2 Çmimet për njësi do të jenë fikse dhe nuk do të ndryshojnë për porositë e bëra në bazë të kësaj Marrëveshje Kuadër.

**Nënshkrimet dhe datat**

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin /Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## Shtojca 23

### Draft Marrëveshja Kuadër Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

**SHËRBIME**

Emri i Autoritetit/Enti Kontraktor,

dhe

Emri i Kontraktorit

Bien dakord si më poshtë:

**Të nënshkruajnë Marrëveshjen Kuadër për objektin**: <shëno titullin> me numrin identifikues: *<shëno numrin e prokurimit>*

**Neni 1 Objekti**.
1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat që do të lidhen përmes procesit të Mini – konkurrimit vetëm midis Operatorëve Ekonomik që janë palë në këtë Marrëveshje Kuadër.

1.2 Kjo Marrëveshje Kuadër nuk është një kontratë në vetvete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen, bazuar në të.

1.3 Kontraktori është vetëm një prej palëve të Marrëveshjes Kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti /Enti Kontraktor, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë Kontraktuesit një "Ftesë për Ofertë" sa herë që ka nevojë për shërbime.

2.2 Kontraktori është i detyruar të paraqesë një Ofertë sa herë që kërkohet nga Autoriteti /enti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër**

1.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkurrimit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrimit**

4.1 Procesi i mini-konkurrimit do të zhvillohet me të gjithë operatorët ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër, kurdoherë që ka nevojë për shërbime nga ana e Autoritetet/entet Kontraktore.

4.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të rihapë konkurrimin në të njëjtat kushte ose kushte të tjera të përcaktuara në Ftesën për Oferta, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit.

4.3 Sa herë që ka nevojë për shërbime, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit Ftesat për Oferta dhe i dërgon ato te të gjithë Operatorët Ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër. Vlerësimi i Ofertave do të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Oferta.

**Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër** ________________________________

**Firmat dhe Data**________________________________________________________

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin/Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**SEKSIONI IV**

**Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

**Shtojca 24**: Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 25**: Formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 26**: Njoftimi i Kontratës së nënshkruar

**Shtojca 27:** Njoftimi i kontratës së nënshkruar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

**Shtojca 28:** Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit në përfundim të afateve të ankimimit

**Shtojca 24**

## FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatoresh ekonomike)*

________________________________________
Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

________________________________________
Nuis/Nipt

________________________________________
Adresa

| | | |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar / Posta |

| | |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

________________________________________
E-mail

________________________________________
Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

| | |
|---|---|
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

*Plotësoni numrin e referencës se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

________________________________________

2. **Lloji i Procedurës**

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP ☐ | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor
*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

_______________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit
(*Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

_______________________________________________

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).*

_______________________________________________

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës
(*Data (viti/muaji/dita*)

_______________________________________________

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit

(*Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme*)

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(*Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës*)

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

1.Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. **Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumenteve të tenderit

☐

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**
*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

| Po | Jo |
|---|---|
| ☐ | ☐ |

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*
_____________________________________________________________________
_____________________________________________________________________

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

____________________________________________________________________
_____________________________________________________________________

7. **Lista e informacionit konfidencial**:
_____________________________________________________________________

____________________________________________________________________

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik** në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

**Shtojca 25:**

## FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

**Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar drejtuar**:

Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i Operatorit/ëve Ekonomikë/Bashkimit të operatorëve ekonomikë**

____________________________________________________________________

Emri i plotë i Operatorit Ekonomik/Operatorëve Ekonomikë (ju lutem shtypeni)
Nuis/Nipt

____________________________________________________________________

Adresa

| | | |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar / Posta |

| | |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

____________________________________________________________________

E-mail

____________________________________________________________________

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për dërgimin e këtyre kundërshtimeve (ju lutemi shkruani)

| | |
|---|---|
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

____________________________________________________________________

*Plotësoni numrin e referencës se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

______________________________________________________________________

**2. Lloji i Procedurës**

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

______________________________________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

______________________________________________________________________

*Vlera e përllogaritur e kontratës/* Marrëveshjes Kuadër *(shuma në shifra dhe fjalë)*

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

______________________________________________________________________

*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader.*

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

______________________________________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

7. Ankesa që po shqyrtohet:

(*emri i Operatorit ekonomik që ka paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi*)

__________________________________________

8. Data e Publikimit të Njoftimit të Fituesit

Data (viti/muaji/dita)

**Seksioni III. Argumentet mbi ankesën e paraqitur nga Operatori/ët ekonomikë**

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. Deklaratë e hollësishme e argumenteve mbi ankesën e paraqitur

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin argumentimet tuaja. Për çfarëdo arsye, specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e këtyre argumenteve. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Tenderit, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë nëse është e nevojshme.*

3. Lista e informacionit konfidencial

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të argumentimeve tuaja, si dhe të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik,** në Sistemin e Ankesave Elektronike.

**Shënim: Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të LPP, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.**

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Operatorit /eve Ekonomikë**

**Shtojca 26**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor)*

# Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

**Seksioni 1 Autoriteti/Enti Kontraktor**

## 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor

Emri ____________________

Adresa ____________________

Tel/Faks ____________________

E-mail ____________________

Ueb-faqe ____________________

**I.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Institucion qendror ☐

Institucion i pavarur ☐

Njësia e Qeverisjes Vendore ☐

Të tjera ☐

1.3 **Procedura e prokurimit për lidhjen e kësaj kontrate është zhvilluar nga:**

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐

Organ Qendror blerës ☐

Ofruesi sherbimit Publik ☐ Privat ☐

I deleguar ☐

Të tjera ☐

**Seksioni 2. Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës / Lotit**

____________________

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"**

**2. Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po ☐ Jo ☐

**Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomik** ☐

**Të gjitha kushtet janë të vendosura** Po ☐ Jo ☐

**2.4 Përshkrimi i shkurtër i kontratës**

2. Fondi limit________________________________________________________________
3. Burimi i financimit ________________________________________________________
4. Objekti i Kontratës ______________________________________

**2.5 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i përfundimit:**

Kohëzgjatja në **muaj** ☐☐☐ **ose ditë** ☐☐☐☐

ose

Duke nisur ☐☐/☐☐/☐☐☐☐ dhe përfunduar në ☐☐/☐☐/☐☐☐☐

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po ☐ Jo ☐

*Nëse po,* numri i LOTEVE: ☐☐

**2.7 Kontrata me nënkontraktim:**

Po ☐ Jo ☐

**Seksioni 3. <u>Procedura</u>**

**3.1 Lloji i procedurës: E kufizuar**

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë: Çmimi □□ **pikët** □

etj. □□ **pikë**

*ose*

**B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim** □

**3.3 Numri i ofertave të paraqitura:** □□□

**Numri i ofertave të rregullta:** □□□

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), kur standardet nuk janë të zbatueshme, aprovimi paraprak merret nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.**

Po □ Jo □

**Seksioni 4 Informacion rreth Kontratës**

**4.1 Numri i kontratës: ___________________________________ Data e kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ______________________________________________________________

Adresa ______________________________________________________________

Nipti ______________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail ______________________________________________________________

Ueb-faqe ______________________________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nënkontraktorit**

Emri ______________________________________________________________

Adresa ____________________________________________

Nipti ____________________________________________

Tel/Faks

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e Kontratës** *(përfshirë shumë, opsione dhe nënkontraktime):*

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha ______________

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ______________

**4.3.1 Vlera totale e nënkontraktimit:** ____

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha ______________

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ______________

**4.4 Informacion Shtesë**

____________________________________________

____________________________________________

Data e dorëzimit të këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 27**

## Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

### 1. Emri dhe adresa e Autoritetit /Enti Kontraktor

Emri ________________________________________________________________

Adresa ________________________________________________________________

Tel/Faks ________________________________________________________________

E-mail ________________________________________________________________

Ueb-faqe ________________________________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ________________________________________________________________**

**3. Objekti i kontratës ______________________________________________**

**4. Numri i referencës së procedurës / Lotit ________________________________________________**

**5. Fondi Limit _________________________________________________________**

**6. Data e Publikimit në SPE** të Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit _______:

[12]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit *[Data] (Numri)*

**7. Vlera totale përfundimtare e kontratës (***përfshirë Lotet, opsionet dhe nënkontraktimin)*:

Vlera ________________ *(me TVSH)* Monedha ____________________________

**8. Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ____________________________________________________________________________

Adresa ____________________________________________________________________________

Numri i NIPT-it _________________________________________________________________

***OE/BOE* me nënkontraktor**

[12] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtij njoftimi në BNJP*

***PO*** ☐ ***JO*** ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Vlera e nënkontraktimit ______________ *me TVSH* Monedha ________________________

**8. Data e nënshkrimit të kontratës**

________________________________________________________________

## Shtojca 28

*(Shtojce për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri__________________
Adresa__________________
Tel/Faks__________________
E-mail__________________
Ueb-faqe_______________________________________________________

**2. Lloji i procedurës: _______________**

**3. Numri i Referencës së procedures/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës ____________________________________________________**

**5. Fondi Limit____________________________________________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

□*në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
□*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
□*konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
□*për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*
□*kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;*
□*kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.*

**7. Data e publikimit** në SPE të Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit:____

[13]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Anullimit nga i cili nisin afatet e ankimit [ Nr] [datë]

**8.** Ankesa pas Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO □ JO□

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

[13] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtij njoftimi në BNJP*

Në përfundim të afatit për paraqitjen e ankesave ______/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to, procedura e prokurimit me objekt "___________", anullohet.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**